



(III)

# UDHA E KRYQIT

NË GJURMËT E TË LUMTURVE

MARTIRË TË KOMUNIZMIT (1948-1974)

NË ISH- BURGUN E SIGURIMIT TË SHTETIT -  
SHKODËR



Tekstet e Udhës së Kryqit janë nxjerrë nga vëllimet e Atë Leonardo Di Pinto-s O.F.M.: *“Imzot Vinçenc Prensushi me Shokë Martirë”*, profil historik hagjiografik, enti botues Arqipeshkvia Shkodër-Pult, Shtator 2016.

Nën kujdesin e Motrave Klarise

Manastiri “Sh. Kjara”- Shkodër-

# UDHA E KRYQIT

**M.** Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt.

**P.** Amen.

**M.** Hiri i Zotit tonë Jezu Krishtit, dashuria e Hyjit Atë dhe ndikimi i Shpirtit Shenjt qoftë me ju të gjithë.

**P.** Dhe me shpirtin tënd.

**M.** Në fillim të udhëtimit të kryqit kërkojmë mëshirën e Zotit:

O Zot, ki mëshirë.

**P.** O Zot, ki mëshirë.

**M.** O Krisht, ki mëshirë.

**P.** O Krisht, ki mëshirë.

**M.** O Zot, ki mëshirë.

**P.** O Zot, ki mëshirë.

**M.** Të adhurojmë o Krisht, e të bekojmë.

**P.** Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

**M.** Të lutemi.

O Zot Jezu Krisht, të ndjekim me fe e me dashuri në rrugën tënde të kryqit. Dhimbja jote qoftë dhimbja jonë. Kryqi yt qoftë kryqi ynë. Vdekja jote qoftë vdekja jonë. Kështu do të jemi me ty në lavdinë e ringjalljes për të gjithë shekuj të shekujve.

**P.** Amen.

*Rrite Zoja tuj lotue,  
afër kryqit tuj shikue,  
Krishtin pezull kryqëzue.*

*Nanë e dashtun, t'lus pa pra,  
varrët e t'brit tand pa da,  
Gjurma n'zemër me m'i ba.*

**TË NDALURIT E PARË**  
**JEZU KRISHTIN E DËNOJNË ME VDEKJE**

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet (Is 42,1)***

“Ja, Shërbëtori im që unë e përkrah, i zgjedhuri im, në të cilin kënaqet shpirti im.

Mbi të e kam ndikuar shpirtin tim; ai do t'ua japë të drejtën popujve”.

***Nga hagiografia e Imzot Vinçenc Prennushit, O.F.M., Arqipeshkëv***

Nga dëshmia e Atit Zef Oroshi: “Imzot Vinçenc Prennushi, Arqipeshkëv i Durrësit, i njohur për shenjtërinë e tij të jetës dhe për vlerën e tij si shkrimtar, sidomos i argumenteve fetare, përveç mundimeve të tjera të panjohura për ne, u torturua prej seksionit të Sigurimit në këtë mënyrë. Pasi e zhveshën, e mbyllën në një kafaz prej hekuri të përgatitur pikërisht për tortura me gozhda me majë përbrenda: aty e rrotulluan gati çdo ditë, për javë të tëra. Më së fundi vdiq.” Në lidhje me këtë, Karlo Grashi ka shtuar: “Në burg, Imzot Prennushi u soll me dinjitet duke mos folur shumë; ishte i qeshur, i kthjellët, i respektueshëm dhe paqësor me të gjithë”. Duket se po realizoheshin fjalët që vetë Imzot Prennushi i kishte shkruar Ministrisë të Përgjithshme të Urdhrit të Fretërve Minorë vite përpara: “Nëse Zoti kërkon fli të reja në këtë fushë tonë misionare, do të themi gjithmonë: u bëftë Vullnesa e Zotit!”.

**M. Të lutemi:**

O Jezhu Krisht, i përvuajtë dhe zemërbutë, i dënuar me pa të drejtë për mëkatet tona. Na shiko me mirësi të gjithë ne, që shpesh jemi të verbër dhe të pandjeshëm, që gjykojmë dhe dënojmë vëllezërit dhe motrat tona. Na e jep neve dhe atyre faljen Tënde! Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

***Heshta zemrën prej trishtimit,  
prej ezgjetit, prej idhnimit,  
Zojës përshkue ia kishte shqimit.***

***Nanë e dashtun, t'lus pa pra,  
varrët e t'brit tand pa da,  
Gjurma n'zemër me m'i ba.***

## TË NDALURIT E DYTË

### JEZU KRISHTI ËSHTË NGARKUAR ME KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

#### ***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 50,6)

“Shpinën ua solla atyre që më rrahnin, mollëzat e mia atyre që ma shkulnin mjekrrën: fytyrën time nuk e largova nga të sharat e pështymat”.

#### ***Nga hagiografia e Dom Lek Sirdanit***

Nuk kishin akuza për t'i bërë Dom Lekës dhe, prandaj, nuk i bënë as gjyq dhe as nuk e dënuan, por vetëm e keqtrajtuan mizorisht, dhe ai megjithëse i sfilur fizikisht, si Krishti, mbajti deri në fund një pamje të kthjellët dhe...heshte. Në përvojën e vet njerëzore dhe të krishterë kishte pasur gjithmonë parasysh se “ bota është plot me lot”, dhe një herë pati shtuar: “ Kjo botë , meqenëse quhet plot me lot, ka nevojë edhe për lotët e mi”. Tortura më shtazarakë qe ajo e hedhjes në gropën e hapur të ujërave të zeza ku, pasi e shtynë në fund me një sfurk, vdiq i mbytur së bashku me dom Pjetër Çunin, ndërsa xhelatët i shanin dhe i provokonin duke u thënë: “ Ku është Krishti juaj? Pse nuk ju ndihmon?”.

#### **M. Të lutemi:**

O Jezus, Zoti ynë, që mbart kryqin në shpatullat e Tua të pafajshme, shikoji të gjithë njerëzit që e shpërfillin dhimbjen dhe lodhjen e të ngjashmëve të tyre. Bëj që të gjithë ne të mund të luftojmë dhe të përpiqemi për lirimin e njeriut. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

#### **Mëshirë për ne, o Zot!**

*Oh sa n'vaj e sa n'ankim,  
ke n'atë çast pa pasë një g'zim,  
Nana Krishtit veç bekim.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E TRETË

### JEZU KRISHTI BIE TË PARËN HERË NËN KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

#### ***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 53,3)

‘‘Ishte i përbuzur më i sprasmi ndër njerëz, njeri dhimbjesh, i regjur me vuajtje, si ai, para të cilit mbulohet fytyra, i përbuzur, këndej as s’e çmonin për gjësend!’’

#### ***Nga hagiografia e Dom Pjetër Çunit***

Dom Pjetër Çuni ishte bariu i mirë i grigjës së vet dhe kudo që ushtroi mbarështimin e vet e vlerësuan dhe e deshën. Ishte një njeri dhe një meshtar i bindur se në lutje gjente bashkimin e tij intim me Hyjin dhe burimet për t’u përballuar me vështirësitë e panumerta që ndeshte gjatë mbarështimit.

Dom Pjetri , ashtu si edhe Krishti, u torturua mizorisht deri në vdekje; nuk iu kursyen shqelmat, grushtet dhe të rrahurat me çdo lloj mjeti. Mes të tjerash pësoi torturën me energji eletrike duke ia vënë dy fijet e korrentit në veshë, gjë vërtet e tmerrshme. Gjatë torturave u la të vdiste me turp, së bashku me dom Lek Sirdanin. Ende i gjallë, megjithëse pa ndjenja, sepse ishte i sfilitur prej torturave, u hodh në gropën e zezë të kazermës. Dom Pjetri përsëriste shpesh: ‘‘ Sikurse Krishti pësoi për fe, po vjen koha që do të pësojmë të gjithë ne, por duhet të qëndrojmë sikurse qëndroi Ai’’.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, të lutemi për të gjithë ne mëkatarët. Na shiko të gjithë me mirësi dhe na shëro nga sëmundjet tona shpirtërore me dashurinë Tënde të mëshirshme. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Kjante dneste e dhimshmja nanë,  
mundue Krishtin për gjithë anë,  
Pa muj kush një ndihmë m'ia dhanë.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E KATËRT

### JEZU KRISHTI HAS NË NËNËN E VET

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

#### ***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 49,1)

“Më dëgjoni, o ishuj, vështroni me kujdes, popuj të largët: Zoti më thirri prej prehrit të nënës, prej barkut të nënës sime iu kujtua emri im.”

#### ***Nga hagiografia e Atë Jozif Papamihalit***

Pasi filloi stuhia komuniste më 29 nëntor 1944, i ftonte të tjerët që të ishin të lumtur dhe të qetë, duke e lënë veten në duart e vullnesës së Zotit dhe që të praninin çfarëdolloj vuajtjeje, deri edhe në vdekjen për të mirën e të gjithëve. Në momentin e arrestimit, i qetë dhe i guximtar, u tha agjentëve të Sigurimit: “Unë nuk merrem me politikë, jam vetëm një njeri i fesë”. U dënua me pesë vjet heqje lirie dhe punë të detyruar. Motra Iulia ka dëshmuar: “Pas hapjes së burgjeve, në 1990, vinin e na takonin shumë persona, që kishin qenë me të në burg. Flisnin për vuajtjet e mëdha që Atë Jozif kishte pësuar, por edhe për dashurinë që ai kishte treguar për shokët e tij të burgut”. Nuk u dorëzua kurrë gjatë hetuesisë së pafund dhe të lodhshme, si edhe nën torturat çnjerëzore. Bindja e fortë se po vuante për Krishtin dhe për Kishën e Tij i mbushi me hirin e shpallur prej Zoti në Malin e Lumturive: “Të lumët ju kur t’ju shajnë e t’ju salvojnë dhe kur, për shkakun tim, t’i thonë të gjitha zezat kundër jush, por në rrenë! Gëzohuni e galdoni, sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell!”. Në fushën e vdekjes së Maliqit, flisnin për të si për një njeri të guximshëm dhe heroik. Fatkeqësisht, i këputur prej lodhjes së punës, ra sfilatur, i gëlltisur edhe prej shushunjave, në kënetën e Maliqit dhe aty u la të vdiste i mbytur dhe si pasojë aty u varros. Vetëm pak javë më përpara kishte mbushur 36 vjeç.

**M. Të lutemi:**

Bëj, o Zot Jezus, nëpërmjet lutjeve të Nënës Tënde të Shenjtë, që ta imitojmë forcën e saj gjatë rrugës së Kalvarit. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Tuj kqyrë nanën e Tenzot,  
afër Krishtit me varrë plot,  
S'asht njeri që s' derdh lot.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E PESTË

### JEZU KRISHTI NDIHMUAR PREJ CIRENEUT

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

#### ***Prej librit të Isaisë Profet (Is 42,6)***

“Unë, Zoti, të thirra në drejtësi e për dore të kam marrë; të kam trajtuar e caktuar besëlidhje të popullit edhe dritë për të gjithë popujt: që t’ua hapësh sytë të verbërve.”

#### ***Nga hagjiografia e Dom Jak Bushatit***

Ishte i zellshëm në ushtrimin e mbarështimit baritor dhe i palodhshëm në shërbimin e popullit. Bujar e bamirës, jetoi në varfëri. Dom Jak jetonte në një dorëzim të plot dhe shpirtëror në Hyjin. Nipi i tij, Ferdinand Bushati, ka thënë. “U arrestua, sepse komunistët ishin fort të bindur se prifti ishte reaksionar, që pengonte përparimin e tyre. Me siguri e dinin se axha nuk e pranonte ideologjinë bolshevike, sepse nuk pranonte parimin e vendosjes së barazisë me dhunë”. Mark Tuci shton: “Duke shtypur atë, regjimi kishte si qëllim të hiqte qafe një shtyllë tjetër të lirisë themelore të njeriut e të të krishterëve, që është feja”. Gjatë kohës së hetuesisë, në burgun e Lezhës, Dom Jak vuajti mundime të patregueshme, aq sa vdiq para se të dënohej, pesë muaj pas arrestimit. Me siguri gyqtarët do të kishin qenë të kënaqur nëse Dom Jaku, për t’u shpëtuar, do t’i kishte pranuar akuzat dhe do ta kishte mohuar fenë e vet. Por Dom Jak nuk e lëshoi veten, pasi ishte formuar për ta vënë fenë mbi gjithçka tjetër, mbi vetë jetën. Lutja që e vetmja shoqëri e atyre ditëve të tmerrshëm, që e pastroi për t’i siguruar hyrjen në lumninë e mbretërisë së qiellit. Më vonë u mor vesh se, në dhomën e hetimit në Lezhë, njëri prej policëve i kishte dhënë një shkelm në bark, aq të fort sa e ka rrëzuar për tokë pa ndjenja dhe kur e ka nxjerr jashtë kishte vdekur.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, na mëso të gëzojmë për të mirën e të tjerëve. Digje me dashurinë Tënde zilinë që gërryen zemrën tonë. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Kush sheh zojën n'atë ezgjet,  
gati dekun për djalë t'vet,  
Pa dnesue, jo, nuk jet.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E GJASHTË

### VERONIKA IA FSHIN FYTYRËN JEZU KRISHTIT

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

#### ***Prej librit të Isaisë Profet (Is 52,14)***

“Sikurse shumë vetë që mbetën shtang kur e panë, kaq e shëmtuar ishte pamja e tij, fytyra e tij s’ishte më si e njeriut, aq sa pamja e tij s’ishte më si e bijve të Adamit, po ashtu mbi Të do të mbesin të habitura turmat e popujve.”

#### ***Nga hagiografia e Atë Gaspër Sumës, O.F.M.***

At Gasper, frat minor dhe meshtar, u arrestua nga *Sigurimi* më 28 maj 1948 në Gomsiqe, ku ishte famullitar e sollen në burgun e Shkodrës në Kuvendin e Gjuhadolit, Epror i të cilit kishte qenë, dhe që ndërkohë ishte marrë nga regjimi dhe ishte shdërruar në hetuesi, vend torturash e burgosjeje. Në atë seli, i torturuar barbarisht, u mor në pyetje natë e ditë. Në intervalet, mes një marrjeje në pyetje dhe një tjetre, mes një torture dhe një tjetre, si edhe në vazhdim, siç kanë dëshmuar ata që kanë qenë në burg me të, i kushtohet lutjes dhe, si apostull i vërtetë dhe besnik, i mësonte të luteshin ata që ishin në burg me të dhe, fshehurazi, i pajtonte me Hyjin vëllezërit në fe. Të gjithë shokët e tij të burgut kanë dëshmuar se Atë Gaspri nuk dukej më ai, aq ishte tretur e shpërfytyruar dhe se, pavarësisht prej dhimbjeve të mëdha që ndiente në trup, tregonte një durim të madh dhe i ishte nënshtruar vullnesës hyjnore. Nuk e kishte ndryshuar aspak natyrën e vet të qeshur dhe shakaxhie. Kur po përfundonte dënimin që i kishin dhënë, 20 ditë para se të lirohej, i sflitur, 53 vjeç, vdiq nga kanceri në infermierinë e burgut. Ishte ‘*Domenica in Albis*’ e vitit 1950 ( e Diela e Bardhë).

#### **M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, Fytyra e Atit, bëj që të dimë të të njohim në fytyrën e vëllezërve tanë, shpesh të shpërfytyruar nga vuajtja, dhimbja, zhgënjimi, frika dhe na ndihmo t’i thajmë me mëshirë dhe kujdes lotët e tyre. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

#### **Mëshirë për ne, o Zot!**

*Mëkatet tona me i resitë,*

*e pa Krishtin krejt molitë,*

*Prej së rrahnash t' asaj ditë.*

*Nanë e dashtun ...*



## TË NDALURIT E SHTATË

### JEZU KRISHTI BIE TË DYTËN HERË NËN KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

#### ***Prej librit të Isaisë Profet (Is 53, 4)***

“Ai i mori mbi vete vuajtjet tona, mbi shpatulla të veta i ngarkoi dhimbjet tona! E ne ishim të bindur se ishte i ndëshkuar, i munduar prej Hyjit e i nënçmuar!”

#### ***Nga hagjiografia e Marije Tucit***

Marije Tuci e pagoj shtrenjtë faktin që ishte e krishterë dhe koherente me zgjedhjen që kishte bërë. Në fakt, pësoi torturat më poshtëruese, derisa e shpërfytyruan në fytyrë e në trup, por ajo diti t'u bëjë ballë me qëndrueshmërinë e karakterit dhe të bindjeve të veta të krishtera. Ka treguar motër Jorgjia Bulgareci, bashkëmoshatare me Marijen dhe, mbyllur Instituti prej regjimit, ishte rikthyer në familje pa e veshur veshën rregulltare: “ Një herë, gjatë kohës së regjimit, më pat marrë malli për Shkodrën dhe nga Tirana u ktheva për një vizitë të shkurtër në qytet. Aty mora vesh se Marija ishte në spital. Shkova në spital e fillova ta kërkoja, por nuk arrita ta dalloja kaq e kishin shpërfytyruar. Në njëfarë momenti, Marija që më njohu, duke folur me zor, më tha: - Jorgjia, shiko si më ka bërë koloneli Hilmi Seiti. Më pat thënë: Do të të shpërfytyroj deri në atë pikë sa as familja jote nuk do të të njohë!- Unë u turbullova shumë dhe ndjeva një dhimbje të madhe brenda meje kur e pashë në atë gjendje. Marija vazhdoi:- Më kanë hedhur vazhdimisht e ngadalë ujë në kokë. Trupi im ishte i lagur gjithmonë. Pa pushim më linin mbi një shtrat të lagur. Shiko si më kanë katandisur! ... Ditët e mia janë duke mbaruar, dëshira e kolonelit të ma marrë jetën, u realizua. Kriminelët e tij nuk kanë lanë torturë pa provuar mbi trupin tim. -”

Kështu e patën katandisur Marijen plot me jetë, dënuar padrejtësisht e lënë të kalbet në lulen e rinis në burgjet e Shkodrës, aty ku pas 50 vitesh, ka qenë themeluar Manastiri i Motrave të Varfëra të Sh. Kjarës. Martire e fesë katolike, sepse ka besuar në Krishtin dhe e ka kumtuar me jetën e saj koherente, Marija është edhe martire e vërtetë për arsye të virgjërisë, që ajo diti ta mbronte me çdo kusht, duke pranuar torturat më të tmerrshme vetëm që të mos i dorëzohej tunduesit.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, kujtohu për të krishterët, që në çdo kontinent të dëshmojnë në përndjekje dhe që martirizohen për besimin. Gjaku i tyre qoftë farë për të krishterët e rinj dhe shenjë e pranisë Sate të amshueshme. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*N'mal t' kalvarit kur e lëshoi,  
vetën kryq, e kur mbaroi,  
Krishtin pau e dhimshmja Zojë.*

*Nanë e dashtun ...*

**TË NDALURIT E TETË**  
**JEZU KRISHTI NGUSHËLLON GRATË**

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 53, 11)

“Shërbëtori im i drejtë do të shfajësojë shumë, mbi vete fajet e tyre do t’i marrë.”

***Nga hagiografia e Mons. Jul Bonatit***

Ai që kundërshtonte për çfarëdolloj veprimi apo shprehjeje të regjimit quhej reaksionar dhe sabotator. Mons. Bonati, njëri shumë i ditur, që punoi për të mirën e katolikëve, pa lënë mënjane përkujdesjet e tij për ortodoksët dhe myslimanët – të cilët e vlerësonin dhe kishin besim në të - u gjend i thithur nga kjo vorbull përpirëse. Pësoi shumë tortura. Mes të tjerash, e goditnin në kokë dhe në trup me një tufë çelësash burgu. Me vështirësi arrinte të mbahej dhe të qëndronte në këmbë. Meqenëse dëshira e tij e madhe ishte të kthehej e të kremtonte Meshën e shenjtë, shqetësohej dhe i thoshte motrës, kur ajo shkonte ta takonte: “Si do t’ia bëj të qëndroj në këmbë për të kremtuar Meshën, meqë më kanë goditur në gjunjë me çelësat të mëdhenjë dhe nuk mbahet dot?”. Duke e torturuar, e detyronin të mohonte fenë, por ai, gjithmonë i vendosur dhe i bindur, thoshte: “Kurrë! Nuk e tradhtoj fenë time!”. Ajo Eukaristi, që e kremtonte me një devocion të thellë, duke bërë që t’i shndriste fytyra, dhe që qe ngushillimi i tij më i madh, i mësoi ritmin e hapit që duhet të mbante për të qëndruar në hapin e Krishtit me qëllim që të ishte, si Krishti, fli pajtuese për përdjekësit e vet.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, të lutemi për të gjithë ne mëkatarët: na e jep hirin për t’u kthyer sa më shpejt.

Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Deh ti nana më dashni,  
dhimbjen tande ban ta ndijë,  
Sa t'jetoj m'këtë shekull t'zi.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E NËNTË

### JEZU KRISHTI BIE TË TRETËN HERË NËN KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,8)***

“E hoqën këso jete me dhunë e me gjyq. Kush kujdeset për fatin e tij? Po, e zhbënë nga toka e të gjallëve, për faj të popullit të vet qe goditur për vdekje.”

***Nga hagjiografia e Atë Karl Serreqit, O.F.M.***

Frat minor, at Karli kishte një karakter të jashtëzakonshëm: spikaste për gëzimin, ëmbëlsinë dhe butësinë e tij. Fytyra ishte pasqyra e shpirtit të tij. Ishte një meshtar i bindur, guximtar, i vendosur, i dashur nga njerëzit. Ishte shumë i rregullt. Më shumë se i përgatitur ishte i mençur, i ekuilibruar, i mbledhur, fjalëpakët, kishte një besim të madh dhe kultivonte me shumë zell shpirtin e devotshmërisë. Megjithëse vinte nga një familje e pasur tregtarësh, zgjodhi dhe jetoj me gëzim dhe thellësi shpirtin e varfërisë françeskane, themeluar në shëmbullin e Krishtit të varfër dhe mbi punën e duarve të veta.

U arrestua, meshtar i ri, në moshën 35 vjeçare. Arsyeja e menjëhershme e arrestimit ka qenë fakti se e kanë kapur duke rrëfyer një armik të komunistëve. Gjatë marrjes në pyetje dhe nën tortura për ta bërë të fliste si donin gjyqtarët, mbajti një qëndrim heroik dhe sjellja e tij në burg ishte shembullore; respektohej edhe nga armiqtë. Kur gjyqtarët e kërcënuan që të tregonte sekretin e Rrëfimit dhe emrat e banditëve të rrëfyer më parë, populli në sallë për ta nxitur që të fliste i thoshte: “ At, thuaje! Ai ka vdekur, t'i shpëto kokën tënde!” Atë Karli, i qetë dhe i vendosur, u përgjigjej: “ Unë një herë i kam bërë betim Hyjit, Rrëfimi është një Sakrament që bëhet në fshehtësi: më parë vdes, sesa të nxjerr atë!” Dhe kështu bëri.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, na bëj të kuptojmë që vetëm duke bashkëndarë dhimbjen e mundimeve të Tua mund ta shohim duke lindur në ne diellin e ngjalljes sate. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Tuj tu lutë gjithmonë po shkoj,*

*ban që Krishtin ta adhroj,*

*Hirin tand kurrë mos ta lëshoj.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E DHJETË

### JEZU KRISHTIN E ZHVESHIN

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

### ***Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,7)***

I marrë me të keq, lejoj të përvujtërohet dhe nuk e çeli gojën; ishte porsiq qengji që e çojnë për ta therur, porsiq delja e pazë para qethtarëve, nuk e çeli gojën e vet.

### ***Nga hagiografia e Dom Ndoc Sumës***

Dom Ndoc Suma, tashmë shëndetlig dhe në gjendje tejet të rëndë fizike për shkak të torturave dhe të burgut, u dënua me 30 vjet burg, të cilat duhet të vuante me punë të detyruar në Beden dhe më pas në Maliq. Kështu Dom Ndoci filloi, një tjetër lloj misioni meshtarak. Ka thënë Tomë Lumçi në lidhje me këtë: “Vjehri im, Pashuk Kola, që ishte me të në punët e detyruar në Maliq, më tregoi se meshtarët ishin një skuadër në vete. Puna ishte e rëndë dhe mbi ta e bënin të rëntomte akoma më tepër. Dom Ndoci, me gjithë moshën e tij dhe kushtet shumë të vështira, nuk humbiste guximin. Ishte i qetë dhe i kthjellët në shpirt. ... Dom Ndoci dhe meshtarët e tjerë ndiheshin të përkrahur nga lutja e vazhdueshme, të shtyrë nga shembulli i tyre, edhe katolikët e tjerë bënin po ashtu. Fshehtazi, Dom Ndoci rrëfente ndokënd”.

Duke parë se jeta e tij po përfundonte, pas tetë vitesh burg u lirua. Pasi ishte kthyer në shtëpi, duke kujtuar vitet e burgut, Dom Ndoci thoshte: “Po të mos ishin meshtarët më të ri për të plotësuar edhe normën time, unë me siguri do të kisha vdekur në kampet e punës”. Vdekja i erdhi ngadalë për arsye të keqtrajtimit. Sëmundja e gjatë dhe e dhimbshme, çdo ditë i sillte në kujtesë vuajtjet e përjetuara. Nuk shprehu kurrë urrejtje apo zemërim për xhelatët e vet. I lidhur ngushtë me Krishtin e derdhi pak nga pak gjakun e vet, pikë-pikë, i sigurt, tamam siç pohon shkolla e lashtë e krishterë: “Gjaku i martirëve u bë fara e të krishterëve”.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, bëj që të zhvishemi prej asaj që s'është e denjë, për t'u veshur me veshjen e bardhë, që Ti na e ke blerë me kryqin Tënd. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Nanë e dashtun, t'lus pa pra,  
varrët e t'birin tand pa da,  
Gjurma n'zemër me m'i ba.*

## TË NDALURIT E NJËMBËDHJETË

### JEZU KRISHTIN E GOZHDOJNË NË KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

### *Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,5)*

“ Kurse Ai ishte i plagosur për shkak të paudhërive tona, i ndrydhur për shkak të fajeve tona; ndëshkimi, peng paqeje për ne, peshoi mbi të: me vërragën e tij ne u shëruam.”

### *Nga hagiografia e Dom Dedë Malajt*

Nuk qe politika, tradhtia e lartë, spiunazhi, bashkëpunimi me armiqtë e popullit dhe akuzat e tjera qesharake që e çuan drejt vdekjes, por karakteri i tij i fortë, zelli i tij meshtarak, veprimtaria e tij shpirtërore në mesin e popullit katolik kaq të përndjekur nga komunizmi ateist, prej 14 vitesh tashmë!

Dom Dedë e vazhdoi gyqin me një guxim të pazakontë. Si fjalë të fundit tha se nuk kishte qenë kurrë trathtar i atdheut të vet dhe se nuk ishte as sot; se ishte prift katolik dhe se ishte i detyruar të kërkonte që t'i falej jeta; se nuk ndihej fajtor për asgjë as para Hyjit, as para Atdheut dhe as para popullit, që i kishte shërbyer edhe me atë që kishte bërë kundër komunizmit; se ishte krenar që po pushkatohej si prift katolik, për Shqipërinë dhe për veshjen që mbante; se u kërkonte ndjesë të gjithë atyre që kishte fyer gjatë gyqit apo në gykatë dhe se i falte ata që e kishin fyer atë; dhe në fund, se i vinte keq për mbesën e vet që po e linte pa askënd. Gjatë gyqit, nuk iu kursye asnjë torturë. Dom Dedë, natën, u pushkatua më 12 maj 1959. Ishte 42 vjeç.

Duke e vrarë, regjimi mendonte se e kishin zhdukur, por qenë ata vet që, me padrejtësitë e tyre, e vunë më në dukje Krishtin që ende sot, falë martirizimit të tij, qëndron më i gjallë se kurrë.

### **M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, Hyji ynë, i gozhduar në kryq për shpëtimin tonë, na jep neve dhe mbarë botës paqen që vjen prej Teje. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

### **Mëshirë për ne, o Zot!**

*Ti pjestar m'ban për gjithmonë,  
n'atë mundim që për faj tonë,  
Hoq mbi kryq shëlbuesi jonë.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E DYMBËDHJETË

### JEZU KRISHTI VDES NË KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 49,6)

“Unë po të caktoj të jesh drita e popujve që shëlbimi im të arrijë në skaj të tokës!”

***Nga hagiografia e Dom Marin Shkurtit***

Diktatori, Enver Hoxha, më 6 shkurt 1967, e shpalli Shqipërinë vend ateist. Me t'u mbyllur, pra, edhe kishën e Stajkës dhe me t'u ndaluar çdo veprimtari baritore, tashmë e konsideruar si krim, Dom Marini iu desh të kthehej në familje dhe të rifillonte të punonte arën, jo më në pronat e familjes, por të Shtetit. Pas pune, me shumë kujdes krenonte Meshën e shenjtë, dhe si mundte, fshehurazi, zhvillonte mbarëshkrimin meshtarak. E gjitha familja e tij ishte në flakë të pushkës, para së gjithash sepse ishte e krishterë, dhe pastaj sepse kishte një meshtar, dhe klasifikohet si reksionare dhe kundërshtar e regjimit, që kërkonte vetëm një shkak për t'i arrestuar të gjithë. Pas arratisjes së krejt familjes në Malin e Zi, që i riatdhesoi menjëherë, të gjithë u arrestuan. Ishin 15 persona. I dërguan në selinë qendrore të Policisë, në Shkodër, sot seli e manastirit të Motrave Klarise, ku iu nënshtruan torturave të tmerrshme dhe qëndruan rreth pesë muaj.

Dom Marini ishte lidhur duar e këmbë dhe i kishin vënë një helmetë në kokë për të shmangur që të vetëvritej duke përplasur kokën për mur, sepse donin të ndienin kënaqësinë e vdekjes prej dorës së tyre. U dënuan që të nëntë, praktikisht të gjithë të rriturit. Kur u shpallën vendimet, ka treguar i vëllai Jaku: “Unë i kapluar nga kaq shumë dhimbje, i thashë Dom Marini që do t'ia kisha marrë gjakun. Por Dom Marini më tha: - Jo, jo, përkundrazi ju më falni mua, për gjithë të keqen që ju kam shkaktuar, por mos i bëni asnjë të keqe askujt dhe nuk keni asgjë për t'u hakmarrë -”. Në moshën 36 vjeçare, për besnikërinë e tij ndaj Krishtit, më 1 prill 1969 u pushkatua.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, i vdekur për të gjithë në kryq, ki mëshirë për ne krijesat e vdekshme. Në çastin e vdekjes, na dil përpara dhe na mirëprit. Na mbart në shpatulla, pasi t'i kesh larë mëkatet tona me Gjakun Tënd të paçmueshëm. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Afër krygj's t'Birit Tenzot,  
ban, o Zojë me derdhun lot,  
Der' sa t'kemi jetë e mot.  
Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E TREMBËDHJETË

### JEZU KRISHTIN E ULIN PREJ KRYQIT

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 53, 11)

“Për shkak të vuajtjes së shpirtit të tij do ta shohë dritën e do të ngihet me njohjen e saj. Shërbëtori im i drejtë do të shfajësojë shumë, mbi vete fajet e tyre do t'i marrë.”

***Nga hagiografia e Dom Shtjefën Kurtit***

Sipas kujtimeve të atyre që e kanë njohur, Dom Shtjefni ishte një njeri i lutjes, i fortë, i vendosur dhe i drejtë. Ishte një tip i kthjellët dhe i shoqërueshëm ... me mirësinë dhe ëmbëlsinë e vet fitonte besimin e të gjithëve. Luigj Vata ka thënë: “Cilido të arrinte të bënte një bisedë me të, largohej gjithë kënaqësi, si të kishte folur m e Zotin”. Shton Atë Lovro Gavran: “... Edhe në mes të regjimit komunist interesohej plot zell për shpëtimin e shpirtave”. E devotshme dhe plot pasion qe lidhia e tij me Kishën dhe me Papën, për besnikërinë ndaj të cilëve, praktikisht, qe dënuar dhe vrarë.

I përndjekur fillimisht në atdhe, në Kosovë, i arrestuar dy herë në Shqipëri, Dom Shtjefni, në fund, u pushkatua 73 vjeç. Kaloi 18 vjet në burg, në dy momente të ndryshme, nga të cilët 17 në burgun e Burrelit, që prej të gjithëve mbahej si burgu i vdekjes.

Gjatë marrjeve në pyetje dhe torturave të tmerrshme, që e bënë copë, reagoi me një ndjenjë të thellë përgjegjësie e dinjiteti. Po ecte po në atë rrugë të dhimbshme që kishte bërë edhe Jezusi Shpëtimtar, dhe kjo i mjaftonte si siguri. “Dom Shtjefni - ka thënë motra e tij, Sheqa – ka vdekur sepse ka bërë detyrën e vet deri në fund, ka dhënë jetën tokësore për atë të amshuar...”. As shpifjet, as akuzat e padrejta, as torturat mizore, as dënimi ... as mjerimi i viteve të fundit të jetës nuk e cenuan dashurinë për Krishtin... dhe për shërbimin e bërë me përkushtim e pasion apostolik ndaj popullit të shpëtuar prej Gjakut të paçmueshëm të Shëlbuesit hyjnor.

**M. Të lutemi:**

O Jezus, ne fshihemi pas plagëve të Tua. Na shpëto nga i keqi, që na sulmon. Na liro nga çdo e keqe. Na bëj ngadhënjyës mbi errësirën, që duket se fiton mbi dritën e ditëve tona.

Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Afër kryqit tue gjimue,*

*Afër tejet tue lotue.*

*Kish të kjajë unë pa pushue.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E KATËRMBËDHJETË

### JEZU KRISHTIN E VARROSIN

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet* (Is 53, 9)

“Varrin e tij e vunë me të patënzonët, me pasanikët varri i tij, megjithëse s’kishte bërë paudhësi, as gënjeshtër s’doli nga goja e tij.”

*Nga hagiografia e Dom Mikel Beltojës*

Tashmë kishin kaluar 15 vjet qysh kur regjimi komunist mori kontrollin dhe pushtetin duke mbjellë tmerr ngado. Megjithatë, pa frikë, me dëshirën për t’u bërë meshtar për të mirën e popullit të Hyjit, Mikel Beltoja, para se të fillonte përgatitjen, rreth moshës 24 vjeçare, në vitin 1959, me guxim kërkoi dhe mori lejen e nevojshme nga regjimi.

Nush Gjuraj kujton: “Kur ai tha të shugurohej meshtar, unë u mundova të kundërshtoja, m’u dhimbe sepse në atë kohë të gjithë meshtarët ishin drejt eliminimit... : - Po si ke vendosur të bëhesh prift, a po sheh se të gjithë priftërinjtë janë duke i burgosur, pushkatuar e internuar? -. ... Mikeli m’u përgjigj: - I kam marrë të gjitha para sysh dhe kam vendosur të vdes për Krishtin -”.

U shugurua meshtar në Katedralën e Shkodrës, së bashku me të Lumin Dom Marin Shkurtin, nga Imzot Ernest Çoba.

[...] Nga Beltoja policët e Sigurimit e çuan në Shkodrës, në Degës së Punëve të Brendshme (tani aty ndodhet Manastiri i Motrave Klarise). Aty qëndroi dërisa vdiq.

Stërnipi i tij, Nush Buzukja, pohon: “... e morën në Beltojë vetëm për ta diskretitur përpara popullit ... dhe e detyronin popullin që t’i kalonte përpara dhe ta pështynte. Vetëm pak njerëz e bënë këtë gjë, sepse atyre u vinte keq dhe duke kaluar përpara tij ulnin kokën në shenjë respekti ...”.

U pyet ditë e natë dhe u torturua mizorisht, por qëndroi heroikisht duke i sfiduar të gjithë si atlet i vërtetë i Krishtit. Kush ka qenë dëshmitar thotë se në të, ndihej forca e Shpirtit Shenjt...

Herën e parë që hyri në sallën e gyqit, në gjendje të mjerueshme, përshëndeti me zë të lartë: “Qoftë lëvduar Jezu Krishti!”, duke marrë si përgjigje sharje dhe fyerje.

Pastaj, i marrë në pyetje, u përgjigj me një ton zëri gjithnjë e më të lartë: “**Po flas, por më parë dua të tregoi një gjë shpejt e shpejt**”, dhe përnjëherësh hoqi kamishën e tij të bardhë për t’u treguar të gjithëve shpinën e zezë, ku dalloheshin qartë shenjat e goditjeve dhe plagët e gjakosura, dhe gjoksit, mbi të cilin po ashtu dalloheshin shenjat e shkaktuara nga goditjet me sende të forta.



Pra foli me guxim dhe plot pasion duke thënë: “Unë e di mirë fundin tim, ju e keni caktuar tashmë atë... Unë e di se komunizmi është armiku i përjetshëm i fesë dhe i kombit. Kjo urretje për fenë dhe veçanërisht për meshtarët, është dëshmuar edhe në vende të tjera... dhe këtu, në Shqipëri, pas ardhjes së kominizmit, me një gjenocid të pashembullt të klerikëve të të trija feve. Unë nuk jam as meshtari i parë dhe as i fundit që jam duke u dënuar. Por Zoti ju faltë, dhe u pendofshi një ditë për ateizmin tuaj. Zoti është i mëshirshëm për ata që kthehen në udhën e pendesës ...”. Dhe përsëri: “...çfarë të keqeje i ka bërë feja kombit? Gjatë shekujve, deri në ditët tona, të trija fetë kanë jetuar në harmoni duke dhuruar forca intelektuale në planin kulturor, moral dhe shpirtëror në dobi të fesë së popullit ... Feja është balsam për shpirtin dhe e çon njeriun kah udha e drejtë e Hyjit, kundër prishjes morale; me mësimet e saj krijon dinjitetin e jetës familjare dhe shoqerore për të mirën e popullit”.

Ka shkruar Pjetër Pepa për të: “Kishte shumë kriminelë, torturues dhe gykatës në atë sallë, ndërsa ai ishte vetëm me Zotin, mbi të cilin kishte besim duke i falur jetën...”.

U flijua si një qengj i panjollë, sepse gjaku i tij, i derdhur jo më kot, të pastronte edhe ata që e kishin dënuar dhe vrarë. Ishte 39 vjeç. Trupi i tij, fatkeqësisht, nuk është gjetur kurrë.

#### **M. Të lutemi:**

O Jezus Shpëtuesi ynë, Ti që ke gjetur vdekjen për të na dhënë jetën e amshueshëm, jepu të vdekurve gëzimin dhe paqen e amshueshme. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*O Zojë virgjër, Nanë e dëlirë,*

*lute Zotin të ketë mëshirë:*

*Ti shëlbim prej si na nxier.*

*Nanë e dashtun ...*

## LUTIA PËRFUNDIMTARE

### Të lutemi

Gjaku i martirëve të tu, o Zot, është bërë fara e Kishës sate.

Na bën të denjtë ta marrim trashëgimin e këtyre vëllezërve  
që na kanë parapri në fe e bën që dëshmia e tyre të jetë gjithmonë  
shembull e udhëheqje në gëzimet e në vështirësitë e jetës.

Na jep sigurinë që edhe në rrënojat e njeriut Ti, o Zot, gjithmonë rindërton e bën të rilindë.

Nëper Krishtin Zotin tonë. Amen.

### **Lutja për Kanonizimin e të Lumëve Imzot Vinçenc Prennushi me Shokë Martirë**

Trini e Shenjtë,  
Atë e Bir e Shpirt Shenjt,  
Ty të qofshin lavdi, ndera e bekimi,  
që ia ke dhuruar Kishës së shenjtë  
të Lumët Vinçenc Prennushi me 37 Shokë Martirë  
si model besnikërie ndaj Krishtit  
dhe dashurie të pakushtëzuar ndaj vëllezërve.  
Të lutemi me përvujtëri:  
ashtu si janë të Lumë tashmë në Qiell,  
denjohu tani t'i lavdërosh edhe këtu në tokë  
duke na dhënë hirin që aq shumë e dëshirojmë  
dhe që, me ndërmjetësinë e tyre të përbashkët,  
me besim të kërkojmë... (këtu bëhet kërkesa).  
Besojmë në Ty, o Zot. Ardhtë Mbretëria jote! Amen.

**Ati ynë. Të falemi Mari. Lavdi Atit ...**

***Shembulli i martirëve tanë na ndhimoftë të jemi  
dëshmitarë të fesë në historinë tonë të përditshme.  
Amen!***

***SHTOJCË***

### ***1- Imzot Vençenc Prennushi, Arqipeshkëv***

Lindi në Shkodër më 04.09.1885. Kushtet e Përjetshme i bëri në Salisburg (Austri) më 12.12.1904. U shugurua meshtar po në Salisburg më 19.03.1908. U zgjodh ipeshkëv i Sapës më 27.02.1936 dhe u shugurua në Shkodër më 19.03.1936. U transferua në selinë arqipeshkvnore të Durrësit më 26.06.1940. U arrestua më 19.05.1947 dhe u dënua me 20 vjet burg më 24.12.1947. Vdiq në burgun e Durrësit prej infarktut, shkaktuar prej keqtrajttimeve, torturave dhe kushteve të këqija ku jetoi, më 19.03.1949. Trupi i tij pushon në kishën e Shën Luçisë në Durrës. Martir i fesë.

### ***2- Dom Lekë Sirdani***

Lindi në Gurëz më 01.03.1891. U shugurua meshtar në Shkodër më 24.04.1916. Famullitar i Bogës, Shkrelit, Reçit e Mazrrekut. U arrestua në Bogë dhe u burgos në Koplik më 27.07.1948. Vdiq gjatë torturave, pa gjyq, i mbytur në gjiriz në Koplik më 31.07.1948, edhe pse lajmi i vdekjes së tij, ndodhur bashkë me Dom Pjetër Çunin, iu dha të atit më 26.12.1948.

### ***3- Dom Pjetër Çuni***

Lindi në Shkodër më 09.07.1914. Filozofinë e bëri në Seminarin Papnor Shqiptar të Shkodrës, kurse Teologjinë në Kolegjin e Kongregatës Propaganda Fide të Romës. U shugurua meshtar në Romë më 23.03.1940. Në fillim qe famullitar në Shkrel dhe pastaj në Rrjoll, prej nga ku shërbente edhe në Lohe e Reç. U arrestua në Rrjoll dhe u burgos në Koplik më 27.07.1948. Vdiq gjatë torturave, pa gjyq, i mbytur në gjiriz në Koplik më 31.07.1948, edhe pse lajmi i vdekjes së tij, ndodhur bashkë me Dom Lek Sirdanin, iu dha të atit më 26.12.1948

### ***4 - Atë Josif Papamihali, Meshtar katolik i ritit bizantin.***

Lindi në Elbasan më 23.09.1912. Filozofi e Teologji studioi në Romë, pranë Angelicum-it. U shugurua meshtar në Romë më 01.12.1935. U kthye në Shqipëri në vitin 1936. Qe famullitar në Elbasan, Korçë dhe Berat, prej nga ku shërbeu edhe në Lushnjë, Pogradec dhe Elbasan; pastaj sërish në Korçë. Prej vitit 1944 qe përgjegjës i Misionit të Kishës Greko-Katolike të Shqipërisë. U arrestua në Korçë më 31.10.1946, ku u burgos dhe u dënua. Më 05.08.1947 u dënua me 5 vjet burg dhe punë të detyrues në Korçë dhe pastaj në Maliq. Vdiq në Maliq, i varrosur i gjallë në kënetë ku kishte rënë, i sfilur prej lodhjes, më 26.10.1948.

### ***5 - Dom Jak Bushati***

Lindi në Shkodër më 07.07.1890. Fillimisht ndoqi shkollën te Fretërit Minorë dhe pastaj në Seminarin Papnor Shqiptar të Shkodrës. U shugurua meshtar në Shkodër më 29.05.1915. Qe famullitar në krahinën e Mirditës: Ndërfanë dhe Gëziq. Prej vitit 1946 qe famullitar i Kallmetit, ku qëndroi deri në fund. U arrestua në Kallmet dhe u burgos në Lezhë në prill të vitit 1949. Vdiq në burg gjatë torturave më 12.09.1949. Trupi i tij u zhvarros prej varrezave katolike të Shkodrës për t'u ekspozuar në kishën Katedrale.

### ***6 - Atë Gaspër Suma, O.F.M***

Lindi në Shkodër më 22.03.1897. Studioi në Shkodër dhe pastaj në Vjenë, Grac e Lankowitz (Austri). Teologjinë në Shkodër dhe Gjenovë. U shugurua meshtar në Gjenovë më 24.07.1921. Dha mësim në Seminarin e Fretërve Minorë të Shkodrës. Famullitar në Përshkash (1923-1924), Nikaj (1927-1931), Toplanë (1932-1942), Theth (1942-1943), prej kuvendit të Brigjeve ka shërbyer në Hot e Rapshtë (1943-1946) dhe në Gomsiqe (1946-1947). Guardian i Gjuhadolit dhe Kapelan i Motrave Stigmatine të Shkodrës. U arrestua në Gomsiqe dhe u burgos në Shkodër më 24.05.1948 dhe më 22.08.1949 u dënua me tre vjet burg. Vdiq prej kancerit në Burgun e Madh të Shkodrës më 16.04.1950. Trupi i tij pushon në kishën e Fretërve Minorë të Shkodrës.

### ***7 - Marije Tuci***

Lindi në Ndërfushaz (Mirditë) më 12.03.1928. E dioqezës së Abacisë Nullius të Shën Llezhdrit të Oroshit në Mirditë, aktualisht dioqeza e Rrëshenit. Ishte aspirante e Motrave të Varfra të Varreve të Shenjta të Shën Françeskut, të njohura si Motrat Stigmatine. Mësuese në Gojan dhe Fan të Mirditës. U arrestua në Ndërfushaz dhe, e burgosur në Shkodër më 11.08.1949, u dënua me tre vjet burg me kusht. Më pas prej torturave të pësuar vdiq si e burgosur në spitalin e Shkodrës më 24.10.1950.

### ***8 - Mons. Jul Bonati***

Lindi në Shkodër, më 24.05.1874. Studioi në Kolegjin Saverian të Jezuitëve të Shkodrës. U shugurua meshtar më 08.04.1906. Në vitin 1912, shkoi në Konstandinopojë, ku qëndroi për disa vite në shërbim të shqiptarëve katolikë që jetonin aty. Më pas, pasi u pranua dhe u emërua meshtar në arqidioqezën e Durrësit, prej vitit 1927 u emërua famullitar i Durrësit dhe Vikar Gjeneral i Dioqezës dhe, prej vitit 1937 deri kur u arrestua, ishte famullitar i Vlorës. U arrestua më 25.03.1946 dhe u burgos në Vlorë, ku u torturua mizorisht. U dënua në Elbasan ku, më 31.10.1947, u dënua me 7 vjet burg. Vdiq në burgun e Durrësit më 05.11.1951.

### ***9 - Atë Karl Serreqi, O.F.M.***

Lindi në Shkodër më 26.02.1911. Teologjinë e studioi në Koleviti të Peshias (Itali). U shugurua meshtar në Torrikio të Peshias më 29.06.1936. Famullitar në Curraj të Epërm (1937-1939), Berishë (1939-1943) e Rajë (1943-1946), prej nga ku shërbente edhe Nikajn e Dioqezës së Pultit, aktualisht i dioqezës së Sapës. U arrestua në Rajë më 09.09.1946. U burgos në Shën Gjergj të Dukagjinit dhe pastaj në Shkodër. Më 08.01.1947 u dënua me varje më 24.02.1947, dënim që iu kthye në dënim me burgim të përjetshëm dhe punë të detyruar në Maliq (Korçë), në fund në burgun e tmerrshëm të Burrelit, ku vdiq prej infarktimit më 04.04.1954. Është Martir i sekretit të rrëfimit.

### ***10 - Dom Ndoc Suma***

Lindi në Sumë (Nënshat) më 31.07.1887. I dioqezës së Sapës. Ka ndjekur Seminarin Papnor Shqiptar deri në vitin e dytë të Teologjisë. Dy vitet e fundit i bëri në Insbruk (Austri) pranë Kolegjit Canisianum të Jezuitëve. U shugurua meshtar në Shkodër më 21.09.1911. Ka qenë famullitar në Koman, Kçirë, Nënshat, Naraç, Laç i Vaut të Dejës, Pistull e Plezhë. U arrestua në Laç të Vaut të Dejës dhe u burgos në Shkodër më 08.12.1946. U dënua më 16.12.1946 me 30 vjet burg dhe punë të detyruar. Pasi u sëmur rëndë u lirua më 25.11.1954. Vdiq në Pistull më 22.04.1958.

### ***11 - Dom Dedë Malaj***

Lindi në Malkolaj (Velipojë) më 16.11.1917. Shkollën fillore e bëri në vendlindje. Ndoqi Seminarin Papnor Shqiptar të Shkodrës. Studioi Filozofi e Teologji në Kolegjin Urban të Propagandës Fide të Romës dhe në Kastel Gandolfo të Romës. U shugurua meshtar në Kastel Gandolfo më 20.12.1942. U emërua famullitar i Pulajve (Velipojë), i Dajçit të Bregut të Bunës dhe i Malkolajve. U arrestua dy herë, në Pulaj të Velipojës më 1948 dhe në Dajç më 07.11.1958 dhe u burgos në Shkodër. U dënua me vdekje më 27.04.1959 dhe u pushkatua në Breg të Liqenit më 12.05.1959. Trupi i tij është zhvarrosur prej varrezave të Dajçit të Bregut të Bunës me rastin e Lumnimit.

### ***12 - Dom Marin Shkurti***

Lindi në Samrish të Dajçit të Bregut të Bunës më 01.10.1933. Tashmë në mes të regjimit komunist, meqë ishte mbyllur Seminari Papnor Shqiptar, u përgatit për meshtar në mënyrë private prej Arqipeshkvit Imzot Ernest Çoba, i cili e shuguroi meshtar më 08.12.1961, së bashku me Dom Mikel Beltojën. U arrestua dhe u burgos në Shkodër më 27.11.1968. Gjyqi iu bë në Dajç. U dënua me vdekje më 20.03.1969 dhe u pushkatua më 01.04.1969.

### ***13 - Dom Shtjefën Kurti***

Lindi në Ferizaj (Kosovë) më 24.12.1898. Studioi në Seminarin e Shkodrës, pastaj në Insbruk (Austri), në Kolegjin Canisianum dhe, në fund, në vitin 1919, në Romë pranë Kolegjit të Kongregatës Propaganda Fide. U shuguroi meshtar në Romë më 13.05.1921. Në vitin 1930, u kthye në Shqipëri, në dioqezën e Durrësit, aktualisht Tiranë-Durrës. Në Kosovë qe famullitar në Ferizaj e Novosel. Në Shqipëri qe famullitar i Zhejës, Gurëzit e Tiranës. U arrestua dy herë: herën e parë në Tiranë më 27.10.1946 dhe u dënua me 20 vjet burg, prej të cilëve bëri 17, në burgun e tmerrshëm të Burrelit; herën e dytë u arrestua në Gurëz më 11.06.1970. U dënua me vdekje. U pushkatua në Gurëz më 20.10.1971.

### ***14 - Dom Mikel Beltoja***

Lindi në Beltojë më 09.05.1935. Tashmë në mes të regjimit komunist, meqë ishte mbyllur Seminari Papnor Shqiptar, u përgatit për meshtar në mënyrë private prej Arqipeshkvit Imzot Ernest Çoba, i cili e shuguroi meshtar më 08.12.1961, së bashku me Dom Marin Shkurtin. Ishte famullitar i Dajçit të Bregut të Bunës dhe e pastaj i Barbullushit. U arrestua në Beltojë dhe u burgos në Shkodër më 19.04.1973. U dënua me 7 vjet burg më 06.08.1973 dhe me vdekje më 04.09.1973. U pushkatua në Shkodër më 10.02.1974.

***.Nën kujdesin e***

***Motrave Klarise***

**Manastiri “Sh. Kjara”**

**Rruga M. Barleti  
Bulevardi Skënderbeg  
Shkodër**

***klaralbania@hotmail.com***